

**Data 16.02.2023  
Ora 17:56**

***RENDI I DITËS***

*Për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

**PJESËMARRJA :**


**KQZ:**

**• Komisioni Rregullator:**

- Ilirjana NANO Kryetar**
- Arens ÇELA Anëtar**
- Dritan ÇAKA Anëtar**
- Helga VUKAJ Anëtar**
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- Stafi KQZ Y. Merkaj, D. Alimehmeti, J. Josifi**
- Parti Politike: S’ka prezent**
- OJQ: KRIIK**

**Znj. I. Nano:** Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në rendin e ditës së mbledhjes është parashikuar një projektvendim, i cili është mbartur nga mbledhja e kaluar e Komisionit Rregullator. Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, verifikojmë pjesëmarrjen. Pjesëmarrës janë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator. Gjithashtu, kemi pjesëmarrës në mbledhje Sekretarin e Përgjithshëm të KQZ-së dhe zyrtarë të tjerë të administratës. Në këndin e subjekteve dhe shoqërisë civile

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2023*

shoh një zotëri, nuk e di, në rregull përfaqësues i KRIIK. Faleminderit! Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit, po pyes kolegët sipas rregullores nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të trajtuar në mbledhje. Nëse jo, fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”. Projektakti ka ardhur si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Shqyrtimi i tij u shty në mbledhjen e kaluar me kërkesë të kolegut Çakaj për t’i dhënë më tepër kohë vetes dhe secilit prej nesh për të reflektuar për përmbajtjen. Do t’i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm një prezantim të shkurtër të ndryshimeve të propozuara dhe shpjegimeve përkatëse. Faleminderit!

**Z. Y. Merkaj:** Faleminderit, zonja kryetare! Në mbështetje të neneve 20, 22 dhe 23 të Kodit Zgjedhor Komisioni Rregullator është organi kompetent për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ të përgatitura nga stafi i KQZ-së ose nga anëtarët e tij për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për mbulimin e aspekteve apo procedura të veçanta të procesit zgjedhor ose heqjen e tyre nga përdorimi. Nga sa më lart kemi përgatitur projektvendimin për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator. Në vitin 2020 Komisioni Rregullator ka miratuar llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet e pajisjeve të votimit dhe numërimit elektronik, që u përdorën për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill 2021. Projektvendimi që propozohet përcakton të njëjtin lloj dhe karakteristika teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që do të përdoren në zgjedhjet në Republikën e Shqipërisë. Ky projektvendim është i natyrës normative dhe për këtë arsye propozohet ndryshimi i pikës 1 të vendimit nr. 4, datë 13.11.2020 të Komisionit


*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2023*

Rregullator në mënyrë të tillë që procedura të jetë e aplikueshme për të gjitha proceset zgjedhore sipas vendimmarrjes a për çdo zgjedhje mbi atë se ku do të pilotohet apo zbatohet procesi i votimit dhe numërimit elektronik. Element kryesor në procesin e votimit dhe numërimit elektronik janë: sistemi elektronik i menaxhimit të votave dhe rezultateve SEMVR dhe pajisjet elektronike të votimit dhe numërimit PENV. Sistemi elektronik i menaxhimit të votave dhe rezultateve bën të mundur konfigurimin e plotë të pajisjeve PENV, si dhe qëndrueshmërinë e të dhënave në mënyrë të sigurt nga të gjitha pajisjet. Gjithashtu, mundëson konsolidimin dhe nxjerrjen e rezultatit pas mbylljes së votimit, si dhe nxjerrjen e rezultatit në çdo qendër votimi nga çdo PENV. PENV-të janë pajisje të sigurta që mundësojnë votimin elektronik, duke ruajtur votën në dy memorie fizike të veçanta, pjesë të së njëjtës pajisje, pa referenca kohore dhe me standardet më të larta të fshehtësisë. Projektvendimi i propozuar ka për qëllim të sqarojë në mënyrë shteruese parashikimet e pikës 10, gjerat “g” dhe “n” të vendimit nr. 4, datë 13.11.2020 dhe për këtë qëllim propozohet ndryshimi i gjerës “g” dhe shfuqizimi i gjerës “n” duke integruar përmbajtjen e dy pikave në një të vetme për të sqaruar përcjelljen e rezultatit nga PENV drejt SEMVR-së vetëm në një kah komunikimi në mbyllje të procesit të votimit. Kjo përcjellje rezultati duhet të mundësohet në mënyrë të sigurt dhe pa cenuar integritetin e informacionit. Ky parashikim bëhet me qëllim të menaxhimit eficient dhe të uljes së kohës së nxjerrjes së rezultatit. Për shkak të shtrirjes së pilotimit të kësaj mënyre, votimi dhe numërimi kërkon organizim logjistik dhe më kompleks për mbledhjen e rezultateve për secilën pajisje dhe për këtë arsye është propozuar që me përfundimin e votimit në ditën e zgjedhjeve PENV-të transmetojnë rezultatin në një komunikim të mbyllur me sistemin qendror në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Për sa më sipër, kemi një projektvendim për shqyrtim dhe miratim. Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2023*

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zoti Merkaj! Fillojmë shqyrtimin në parim të projektvendimit. Kolegë, kush e do fjalën? Nga ana e KRIIK-ut ka diçka lidhur me projektvendimin? Faleminderit! Kalojmë në votimin në parim të projektit.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka**

Me 5 vota pro, miratohet.

Shqyrtimi pikë për pikë i projektaktit. Atëherë Komisioni Rregullator vendosi: 1. Në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020 të Komisionit Rregullator, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë: shkronja “a”, pika 1, ndryshohet si më poshtë: “Procesi i votimit dhe i numërimit elektronik të votave, ku do të zbatohen projektet pilot, do të kryhet me anë të sistemit dhe/ose pajisjeve elektronike, sipas përcaktimeve të këtij vendimi”. I votojmë shkronjë për shkronjë dhe pastaj gjithë pikën në tërësi?

**Me shkronjën “a” kush është dakord?**


**Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka.**

Me 5 vota pro miratohet.

Shkronja “b”. Sipas propozimit, shkronja “g” e pikës 10 ndryshohet si më poshtë: “Gjatë procesit të votimit pajisja elektronike e votimit dhe e numërimit PEVN vepron në mënyrë autonome dhe pa u lidhur në rrjetet e komunikimeve elektronike. Pas mbylljes së procesit të votimit, për qëllimin e pasqyrimit të rezultatit paraprak në zgjedhje, PEVN-ja të mundësojnë transmetimin e këtij rezultati drejt sistemit elektronik të menaxhimit të votave dhe rezultateve SEMVR dhe jo anasjelltas, me siguri maksimale dhe pa cenuar integritetin e informacionit”. Kemi diçka për shkronjën “b”? Po, zoti Çakaj.

*Zbardhi materialin audio  
Alina KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2023*

**Z. M. Çakaj:** Po, faleminderit, zonja kryetare! Lidhur me propozimin nga administrata për ndryshimin e shkronjës “g” të pikës 10 të vendimit nr. 4, së pari, unë propozoj që shkronja “g” e pikës 10 të qëndrojë siç është, por ndryshimi, dhe unë kisha një propozim konkret pasi e kam lexuar propozimin e Komisionerit dhe, në fakt, e mendoj ndryshe riformulimin, dhe konkretisht propozoj që ndryshimi të bëhet në shkronjën “m” të pikës 10 dhe teksti se si të riformulohet shkronja “m” është konkretisht ky: “Pas mbylljes së procesit të votimit, për qëllimin e pasqyrimin të rezultatit paraprak të çdo qendre votimi, PEVN-ja, pasi printon procesverbalin e rezultatit të votimit, mundëson transmetimin e këtij rezultati me siguri maksimale dhe pa cenuar integritetin e informacionit, drejt sistemit elektronik të menaxhimit të votave dhe rezultateve (SEMVR) në KQZ dhe jo anasjelltas. Rregullat mbi llojin e të dhënave që transmetohen, raportet e printuara nga PEVN-ja dhe administrimin e tyre miratohen me akt të Komisionit Rregullator”. Pra, konkretisht propozimi im konsiston në dy pika. Së pari, shkronja “g” e pikës 10 të mos ndryshohet, pra, të rrijë siç është, dhe të bëhen ndryshime në shkronjën “m”, sipas riformulimit. Shkronja “m” të riformulohet sipas leximit konkret.

**Znj. I. Nano:** Atëherë, kolegë, ka komente të lidhur me propozimin e kolegut, përpara se të kalojmë në votim? Me sa kuptova bëhet fjalë për një printim paraprak të rezultatit, më pas transmetim të këtij rezultati drejt sistemit nga ana e çdo PEVN-je dhe më tej rregullat e detajuara për mënyrën e transmetimit do të miratohen nga Komisioni Rregullator. Në fakt, është atributi dhe tagri ynë për të miratuar rregulla procedurale, ku të përfshihen rregullat për transmetimin dhe llojin e informacionit që transmetohet.

**Z. M. Çakaj:** Paraprakisht ne me vendimin nr. 4 të vitit 2020 kemi miratuar llojin dhe karakteristikat teknike, që duhen të kenë pajisjet elektronike të votimit dhe të

*Zbardhi materialin audio*

*Alma KOLA*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2023*

numërimit. Kuptohet Kodi Zgjedhor këtë gjë e parashikon si risi, e parashikon edhe si projekt pilot. Është implementuar në zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, besoj me sukses në një KZAZ, në KZAZ-në nr. 10 në Tiranë, dhe në zgjedhjet e pjeshme është implementuar projekti pilot i votimnumërimit në njësinë administrative në Bashkinë e Vorës. Në këto zgjedhje është propozuar projekti pilot të implementohet më gjerë. Në këto kushte, nisur edhe nga qëllimi i implementimit të futjes së teknologjisë në zgjedhje, pra projekteve të votimit dhe numërimit elektronik, qëllimi jo vetëm i ligjvënësit, por edhe qëllimi i jonë si administratorë të parë të zgjedhjeve, është që, së pari, të kemi transparencë në raport me qytetarët shqiptarë dhe së dyti, dhe përcjelljen e informacionit me saktësi, me integritet, por edhe me shpejtësi. Pra, të transmetohet, nga ana tjetër, të gjitha palët, të cilat kanë interes të drejtpërdrejtë për sigurinë e informacionit, duhet të garantohen nga ana tjetër që kanë dhe rezultatin e printuar. Pra, ajo çfarë transmetohet, paraprakisht të jetë e printuar, dhe, sigurisht, sipas rregullave të posaçme, që ne do të vendosim, do të përcaktojmë edhe llojin e të dhënave por edhe mënyrën e administrimit të tyre. Këtu konsiston propozimi.

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Personalisht bie katërçipërisht dakord me propozimin e bërë nga kolegu. Pas diskutimit dhe analizës së përbashkët që kemi bërë, të kësaj risie të transmetimit paraprak të rezultat për votuesit dhe njëkohësisht për subjektet, kemi diskutuar dhe rrahur mendime, të cilat ishin garancitë e kësaj risie ose të implementimit të kësaj risie nga rregulli i përgjithshëm. Dhe një nga garancitë ishte momenti, pra, ndarja në dy sekuenca të momentit të printimit të rezultatit, pra, si një dokument material, dhe më pas transmetimit. Pra, transmetimi paraprak i rezultatit ndërvaret ose është hapi sekondar, i cili paraprihet nga printimi. Pra, kjo është një garanci e shtuar dhe, në të njëjtën kohë dokumenton për së pari,

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2023*

përmes fletës së printuar, rezultatin, dhe kjo garanton subjektet që aludimet e mundshme mbi transmetime paraprake të intervenuara, nuk mund të ketë, pasi dokumenti materializohet dhe vendoset ose do të vendoset se ku do të printohet dhe administrohet. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zonja Vukaj! Kolegë, a keni ndonjë gjë për të shtuar? Nëse jo, kalojmë në votimin e shkronjës “b” me përmbajtjen e propozuar nga kolegu Çakaj.

**Me shkronjën “b” kush është dakord?**

**Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)**

**Kundër: S’ka.**

*Me 5 vota pro miratohet.*

Shkronja “c” e propozuar me këtë përmbajtje: “Shkronja “n” e pikës 10 shfuqizohet. A kemi ndonjë diskutim, apo kalojmë në votim? Nëse jo, kalojmë në votimin e shkronjës “c”.

**Me shkronjën “c” kush është dakord?**

**Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)**

**Kundër: S’ka.**

*Me 5 vota pro miratohet.*

Përpara se të kalojmë te pika 2 kam unë një propozim për të shtuar edhe një pikë “ç” ose “d”, pra një pikë tjetër pas pikës “c”. Duke iu referuar aktit bazë të cilin sot po e shqyrtojmë duke e ndryshuar në pikën 12 të tij, parashikohet: “Me qëllim implementimin dhe përdorimin e sistemit elektronik të votimit dhe numërimit, në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 prill, të vitit 2021...” e të tjera. Kjo dispozitë, ishte dispozitë e posaçme për zgjedhjet e datës 25 prill dhe kishte një parashikim specifik për këto zgjedhje. Duke qenë që akti vijon të jetë në fuqi për dispozitat e tjera, mendoj dhe vlerësoj të kërkoj shfuqizimin e pikës 12, të vendimit nr.4 datë 13.11.2020. Po e propozoj kolegë shfuqizimin e pikës 12.

*Zbardhi materialin audio*

*Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2023*

***Kush është dakord me propozimin?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Me 5 vota pro miratohet.*

Atëherë, duke qenë se në pikën 1 të projektvendimit kemi bërë dy ndryshime, pra një ndryshim dhe një shtesë do t'ju ftoja ta votojmë në tërësi pikën 1.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Me 5 vota pro miratohet.*

Kalojmë në pikën 2. “Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.”

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Me 5 vota pro miratohet.*

Pika 3. “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Me 5 vota pro miratohet.*

Pika 4. “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Gjyqësor Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.”

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2023*

*Me 5 vota pro miratohet.*

Votojmë në tërësi projektvendimin, pasi e kemi votuar në parim dhe pikë për pikë. Edhe njëherë kolegë dakordësinë tuaj lidhur me këtë pikë.

***Kush është dakord me projektvendimin në tërësi?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Me 5 vota pro miratohet.*

Ngaqë nuk kemi çështje tjetër në rendin e ditës ose jashtë rendit të ditës për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!

**Vendimi nr. 6**

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*

